

KONGRESI I VIII-të I EUROSAT-t

LISBONË 30 MAJ-2 QERSHOR 2016



Kongresi i VIII-të i EUROSAT-t u zhvillua në Lisbonë, Portugali në datat 30 maj deri 2 qershor 2011 dhe u përqendrua në dy tema kryesore :

Tema e I-rë trajtoi Sfidat, kërkesat dhe përgjegjësitë e menaxherëve publikë dhe rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit. Kjo temë u nda, për diskutim, në dy nën-tema: nën-temë I.A, lidhur me sfidat dhe kërkesat me të cilat përballen menaxherët publikë sot, dhe nën-temë I.B, që i referohej rolit të SAI-ve në llogaridhënie dhe përgjegjësitë e menaxherëve publikë.

Objekti i Temës së II-të ishte Auditimi i Agjencive të Pavarura rregullatore nga Institucionet Supreme të Auditimit.

Kongresi i VIII-të i EUROSAT-t
Lisbonë, 30 Maj-2 Qershor 2011
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Preambula

Kongresi VIII Kongresi i EUROSAT-t i mbajtur në Lisbonë, më 30 maj në 2 qershor 2011 u fokusua në dy tema kryesore. Tema e parë trajtonte “Sfidat, kërkesat dhe përgjegjësit e menaxherëve publikë dhe rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit. Kjo teme u nda për diskutim në dy nën-tema: nëntema I.A, në lidhje me “sfidat dhe kërkesat aktuale me të cilat përballen menaxherët publikë dhe nëntema I.B, që i referohet “rolit të SAI-ve në llogaridhënien dhe përgjegjësitë e menaxherëve publikë. Objekti i Temës II ishte “auditimi i Agjencive të Pavarura Rregullatore nga Institucionet Supreme të Auditimit”. Për secilën temë (dhe nën-temë) u ngrit një grup pune nga SAI-et, i përbërë nga një kryetar dhe një raportues, me mbështetjen e SAI-t të Portugalisë. SAI i Holandës (kryetari) dhe SAI i Sllovenisë (raportues) për nën-temën I.A., SAI i Spanjës (kryetar) dhe SAI i Francës (Raportues) për nën-temën I.B., dhe SAI-et e Polonisë (kryetar) dhe i Mbretërisë së Bashkuar (raportues) për Temën II. Këto grupe pune përgatitën dokumentet kryesore dhe dokumentet e diskutimit për Kongresin.

Anëtarët e EUROSAT-t kontribuan, me dokumentet e tyre përkatëse, në shkëmbimin e eksperiencave mbi bazën e një diskutimi të gjerë.

Kumtuesit e Kongresit dhanë një kontribut të rëndësishëm për një debat të frytshëm, i cili u pasurua nga përfshirjet në diskutim të pjesëmarrësve. Draft-konkluzionet dhe rekomandimet e Kongresit të VIII të EUROSAT-t janë rezultat i një pune të përbashkët të SAI-ve të sipërcituara dhe të të gjithë kontribuesve.

Tema I- Sfidat, kërkesat dhe përgjegjësitë e menaxherëve publikë dhe roli i SAI-ve.

Konkluzionet:

Marrë në konsideratë se:

- Dokumentet e dërguara nga SAI-et dhe debati i zhvilluar nga Kongresit të VIII të EUROSAT nënvizuan emergjencën e realiteteve të reja në shoqëri me një impakt të rëndësishëm në menaxhimin publik e për rrjedhojë në llogaridhënie;
- Zhvillimet demografike dhe teknologjike, situata aktuale financiaro-ekonomike dhe shoqëria e informacionit janë faktorë me të cilat të gjithë qeveritë duhet të përballen;
- Bota po ndryshon më shpejt sesa më parë dhe qeveritë duhet të reagojnë më shpejt për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve të tyre;
- Ndryshimet në sektorin publikë kërkojnë që edhe SAI-et të përshtaten;
- Nuk ka një rrugë unike për t’i adresuar këto sfida dhe përpos autoritetit ligjor të shtetit ka nevojë edhe për një formë qeverisëse të hapur, reaguese dhe të përshtatshme, brenda së cilës vlerat etike bashkëndahen dhe respektohen;
- Llogaridhënia është një koncept kompleks dhe një gurthemel në menaxhimin publik bashkëkohor.

Anëtarët e EUROSAT-t, të mbledhur në Kongresin e VIII, vendosën që:

1. Zhvillimet e sipërcituara kërkojnë nivele të larta të transparencës në informacionet e qeverisë, si dhe krijimin e mjeteve dhe qasjeve, të cilat i lejojnë menaxherëve publike që të reagojnë shpejt ndaj ndryshimeve;

2. Shtetet ndryshojnë në qasjen e tyre ndaj sfidave, duke marrë në konsideratë rregullat dhe interpretimin e rregullave, burimeve njerëzore, etikën e menaxherëve publikë si dhe inovacionin dhe fleksibilitetin.

3. Transparenca dhe llogaridhënia janë të dyja vlera demokratike dhe thelbësore për qeverisjen e mirë. Llogaridhënia është një koncept i gjera që përfshinë një gamë përgjegjshmërisë menaxherët publikë, si aftësia menaxheriale dhe profesionale, përputhshmërinë me kuadrin rregullator financiar e rregulla të tjera, arritja e pritshmërive të performancës dhe sjellja etike;

4. Nëse menaxherët publikë duhet të fitojnë besimin publik, ata duhet të jetë të ndërgjegjshëm mbi pritshmëritë e qytetarëve në lidhje me qeverisjen e mirë. Ata mund ta realizojnë këtë nëpërmjet edukimit, komunikimit, fleksibilitetit, forcimit të vlerave etike dhe forcimit të llogaridhënies.

5. Shumica e SAI-ve shohin një tension sfidues në qeverisje mes procesit demokratik të ligjvënies dhe kontrollit në një anë dhe fleksibilitetit për të reaguar shpejt ndaj zhvillimeve në anën tjetër. Qeveritë orvaten që të arrijnë një balancë mes sigurisë ligjore dhe fleksibilitetit, duke respektuar sundimin e ligjit. Anëtarët e EUROSAT-t besojnë se nuk ka kontradiktë mes fleksibilitetit të një modeli të sistemit të hapur në një anë dhe llogaridhënies në anën tjetër;

6. Vlerësimi i performancës dhe raportimi luajnë një rol kyç në sigurimin e një përgjegjshmërie të menaxherëve publike, sidomos në një kohë kur qasja e bazuar në rregulla po përforcohet nga një qasje e bazuar në parime;

7. SAI-et kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në promovimin e një kulturë të llogaridhënies dhe në lehtësimin e procesit të llogaridhënies, përmes auditimit, raportimit, lëshimit të rekomandimeve, reflektimit të praktikave të mira dhe në disa raste nëpërmjet pushteteve ligjore apo sanksioneve. Ata mund të bashkëpunojnë me palë të tjera të interesit për të zhvilluar një kornizë llogaridhënieje bazuar në parime;

8. Është e rëndësishme që vetë SAI-t të operojnë mbi bazën e pavarësisë, transparencës dhe efijencës për t'i bërë ballë sfidave në sektorin publik;

9. SAI-et garantojnë që detyrimet ligjore janë adresuar, në bazë të mandatit të tyre;

10. Nëpërmjet auditimeve dhe rekomandimeve, SAI-et luajnë një rol si katalizator për përmirësime në legjislacion dhe në praktikat administrative, duke forcuar kështu llogaridhënien.

11. Rekomandimet

Duke marrë në konsideratë konkluzionet e sipërcituara, anëtarët e EUROSAT-t, të mbledhur në Kongresin e VIII të EUROSAT-t, rekomanduan se:

1. SAI-et përshtaten ndaj inovacioneve dhe ndryshimeve në shoqëri;

2. SAI-et gjejnë rrugë për të angazhuar me shoqërinë civile në punën e tyre;

3. SAI-et promovojmë respekt për rregullat ligjore, menaxhimin e shëndosh dhe parimet etike;

4. SAI-et promovojnë dimensione të ndryshme të llogaridhënies, së jashtmi, por edhe brenda organizatave të tyre;

5. SAI-et orvaten të zgjerojnë fushëveprimin e tyre për të përfshirë llogaridhënien financiare, ligjore dhe performance;
6. SAI-et marrin një rol pro-aktiv drejt legjislativit dhe sektorit publik, më qëllim përforcimin e llogaridhënies në menaxhimin publik;
7. SAI-et raportojnë mbi rolin e tyre në sigurimin e përgjegjshmërisë ligjore;
8. Brenda kornizës së Planit Strategjik të EUROSAT-t, miratuar nga ky Kongres, EUROSAT ndërtoi mbi këtë temë, via një dialogu të strukturuar apo ndonjë forme të përshtatshme përpjekjesh të përbashkëta, si për shembull një task-forcë, në mënyrë që t'i bëjë ballë sfidave të ndryshimit dhe të ndajë rezultatet me komunitetin e gjerë INTOSAT, bazuar në moton "Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë".

Tema II: Auditimi i Agjencive të Pavarura Rregullatore nga SAI-et

Konkluzione

SAI-et anëtare të EUROSAT-t, të mbledhur në Kongresin e tij, konkluduan se:

1. Rregullatorët janë një element i rëndësishëm dhe në rritje në relievin e sektorit publik në shumë shtete europiane. Zhvillimi i tyre është rezultat i shumë faktorëve përfshirë:

- Privatizimin e industrive të infrastrukturës, e cila ka sjellë nevojën për të forcuar mbikëqyrjen rregullatore në sektorin privat;
- Nxitjen për të forcuar efektivitetin e tregjeve, si në terma të konkurrencës, de-rregullimit, liberalizmit si dhe mbrojtjes së konsumatorëve; dhe
- Shqetësimin nga risqet që sjellin aktivitetet e shërbimeve financiare për ekonominë globale dhe konsumatorëve si individë.

2. Si rezultat, nuk ka një përkufizim të vetëm të rregullimit. Rolet rregullatore dhe funksionet janë shumë dhe ndryshojnë nga një vend në tjetër. Megjithatë, ka tre grupe kryesore të rregullatorëve tek anëtarët e EUROSAT-t:

- a. Rregullatorët infrastrukturës;
- b. Rregullatorë të konkurrencës dhe konsumatorëve ;
- c. Rregullatorët e shërbimeve financiare.

3. Megjithëse rregullatorët e pavarur nuk janë të mëdha nëse flasim për shpenzimet direkte, ata janë aktorë të rëndësishëm ekonomikë. Ata mbulojnë pjesë të rëndësishme të PPB-së së një vendi dhe marrin vendime të rëndësishme- mbi strukturat e tregut, çmimet dhe mbi aktorët e përveçëm si kompanitë apo individët.

4. Kriza ekonomike ka çuar në rritjen e rolit të rregullatorëve ekonomike në vendet e EUROSAT-t. Në disa raste, rregullatorët ekzistues kanë marrë kompetenca të theksuara për të mbrojtur konsumatorët dhe për të garantuar stabilitetin financiar; ndërkohë që gjetkë, rregullatorë të rinj të pavarur po ngrihen për të adresuar të metat e hasura në regjimin aktual rregullator. Në disa vende, reformat strukturore po dëshmojnë zgjerimin e rolit të bankës qendrore në mbikëqyrjen e stabilitetit financiar. Kjo mund të komplikojë auditimin nga SAI-t të kuadrit rregullator sepse jo të gjitha SAI-t kanë kompetencë mbi bankat qendrore.

5. Nëse kuadri rregullator fokusohet mbi infrastrukturën, konkurrencën e përgjithshme ose shërbimet financiare, pavarësia e funksionit rregullator nga vendimmarrja e Ministrisë është një tipar i zakonshëm përmes Europës. Kjo pavarësi nënkupton se rregullatorët mund të marrin vendime mbi aktorët individual (kompanitë, individët) mbi bazën e parimeve të përgjithshme rregullatore- të lira nga presionet politike.

6. Disa tipare të qeverisjes përforcojnë pavarësinë rregullatore, përfshirë:

- a. Një përcaktim të qartë dhe preciz të fushëveprimit, mandatit dhe përgjegjësi të vendosua në ligj;
- b. Kushte të qarta pune për menaxhmentin e lartë të rregullatorëve dhe një gatishmëri për të paguar një pagë bazuar në treg, në mënyrë që të tërheqë individë të aftë;
- c. Pavarësi financiare nga qeveria.

7. Rregullatorët dhe SAI-et kanë shumë tipare të përbashkëta. Ata kanë kompetenca të ndryshme me të cilat kontribuojnë në qeverisjen e mirë dhe menaxhimin në sektorin publik, por të dyja, në rrënjë, kanë si qëllim mbrojtjen e qytetarëve. Në këtë mision, të dy mbështeten në pavarësi. Të dyja janë komentues autoritativë dhe me ndikim në shoqëritë pluraliste e gjithnjë e më komplekse në të cilën ata shërbejnë. Prandaj ekziston një rast bindës për dialog dhe ndërveprim profesional ndërmjet rregullatorëve dhe SAI-t - një bashkëpunim “i mençur”.

8. Megjithatë, llogaridhënia varet dhe forcohet nga ekzistenca e një sfide për SAI-t. Pavarësia e rregullatorëve dhe rëndësia e tyre si aktorë ekonomike nënkupton se ata duhet të shqyrtohen nga Parlamenti për të siguruar që i kanë ushtruar në mënyrë të përshtatshme kompetencat e tyre. Shumica e SAI-ve kryejnë auditim financiar, por në shumë vende, fushëveprimi i SAI-ve nuk shtrihej përtej kësaj; madje edhe në ato vende ku SAI-ve u lejohen auditime financiare, kjo kompetencë nuk është shumë e zgjeruar në sektorin e shërbimeve financiare.

9. Përpos auditimeve financiare, vendimet individuale rregullatore (p.sh. mbi shkeljet e kompanive të veçanta) i nënshtrohen rishikimit ose përmes gjykatave ose përmes shqyrtimeve të tjera administrative. Megjithatë, kjo nuk është një tipar i përhapur tek SAI-et. Institucionet Supreme të Auditimit kryejnë gjithashtu auditimi mbi efektivitetin ose kosto-përfitimin e rregullatorëve. Ky lloj auditimi është më i zakonshmi për rregullatorët e infrastrukturës dhe më pak i zakonshëm për rregullatorët e shërbimeve financiare.

10. Auditime të tilla kanë objektiva dhe qasje të ndryshme. Por në thelb, SAI synon që t'i ofrojë parlamentit dhe shoqërisë garanci mbi mënyrën sesi një rregullator i pavarur ka përdorur diskrecionin për të arritur objektivat e tij. Për shumicën e SAI-ve, auditimet e rregullatorëve mbulojnë:

- Mënyrën sesi prioritzon ngarkesën e punës;
- Strategjitë;
- Përputhshmërinë me detyrimet ligjore.

Disa SAI kanë mundësinë të komentojnë mbi vendimet ekonomike të rregullatorëve ekonomikë të tilla si çmimet që mund të vendosin kompanitë e infrastrukturës ose mbi qasjen e vlerësimit të efektivitetit.

11. Një faktor kyç për SAI-et është ndryshimi mes çështjeve të menaxhimit financiar dhe llogaridhënies politike. Nëse kjo nuk përkufizohet dhe kuptohet qartazi nga SAI-et, ka rrezik që raportet,

konkluzionet dhe rekomandimet e tyre mund të shihen si një zgjatim i papërshtatshëm në fushat e politikës. Megjithatë, Kongresi XX i Johannesburgut në 2010, në miratimin e raportit të Task Forcës së INTOSAI-t mbi Krizën Financiare Botërore, komentoi se duke kryer auditime performance në Agjencitë Rregullatore, SAI-et mund të ndërgjegjësohen mbi risqet strategjike dhe të metat e sistemit rregullatorë dhe luajnë një rol konstruktiv mbikëqyrës mbiu reagimin qeveritar ndaj krizës.

12. SAI-et po vlerësojnë nëse rregullatorët po arrijnë alokimin optimal të burimeve. Kjo është një çështje komplekse dhe përfshinë gjykime jo vetëm mbi rregullatorët e menaxhimit të brendshëm por edhe impaktet ekonomike që këto rregullatorë kanë arritur. SAI-et arrijnë të bëjnë gjykime më të sakta kur vetë rregullatorët ndërmarrin vlerësime rigorozë të impaktit ekonomik të tyre.

13. Me rritjen e globalizimit, ku ekonomitë tona po preken më shumë se kurrë nga përvojat, dobësitë dhe fuqitë e palëve të tjera përtej kufijve tona, ne duhet të bashkëpunojmë më ngushtësisht e përtej kufijve tanë për të rritur efektivitetin e punës së SAI-ve. Shqyrtimi i temës nga anëtarët e EUROSAT-t kanë zbuluar një hendek serioz në lidhje me auditimin publik të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare që financohet nga kontributet kombëtare. Është esenciale që këto organizata të jenë plotësisht transparente dhe subjekt i një auditimi të jashtëm të përshtatshëm. Për të përmbushur mandatin e tyre, SAI-et duhet të vendosen në një pozicion që të raportojnë në Parlament mbi performancën e këtyre organizatave.

14. Megjithatë, për të pasur një mandat të gjerë, SAI-t duhet të njohin se të drejta të tilla, me kalimin e kohës, shndërrohen në detyra. Në kryerjen e auditimeve të tilla – në një nivel kombëtar ose mbi-kombëtar – SAI-t duhet të sigurojnë se i kanë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme.

Rekomandimet

Bazuar në konkluzionet e mësipërme, anëtarët e EUROSAT-t, të mbledhur në Kongresin VIII EUROSAT, rekomanduan se:

1. Megjithatë kanë një gamë të gjerë kompetencash, pavarësia diskrecionale e rregullatorëve nënkupton se ata duhet t'i nënshtrohen një shqyrtimi të jashtëm rigoroz, përfshirë nga SAI-t, në përdorimin e burimeve financiare dhe eficiencës së tyre.
2. Ky kongres mbështet auditimin e rregullatorëve nga SAI-t, përfshirë ato përgjegjës për mbikëqyrjen financiare(bankat qendrore).
3. SAI-ve u nevojitet të shqyrtojnë kontekstin institucional të veprimit të rregullatorëve, veçanërisht mekanizmat qeverisës të hartuara për të siguruar pavarësinë rregullatore.
4. Aty ku rregullatorët janë ngritur me një vendimmarrje të qartë të pavarur, një pyetje thelbësore që duhet të shtrojë një SAI lidhet me risqet që pavarësia rregullatore të jetë e kompromentuar ose nga ndërhyrjet e industrisë rregullatore ose nga ndërhyrja politike e qeverisë.
5. Mjedisi ekonomik ka një impakt të rëndësishëm në punën e rregullatorëve dhe kriza e fundit financiare ka nxitur shumë ndryshime. Prandaj, SAI-et duhet të përshtasin punën e tyre audituese mbi rregullatorët e pavarur bazuar në kontekstin ekonomik, duke u fokusuar në risqet ekonomike dhe në përdorimin me eficiencë të burimeve të limituara.

6. SAI-et duhet t'i inkurajojnë rregullatorët të ndërmarrin vlerësime sistematike të impaktit dhe efektivitetit të tyre, bazuar në një kornizë performance menaxhimi që ndërlidh inputet, aktivitete, outputet dhe rezultatet me objektivat përfundimtar të secilit rregullator.

7. Opinioni i një organi të pavarur dhe objektiv si një SAI mund të ndikojë në treg. SAI-et duhet të jenë të ndërgjegjshëm ndaj kësaj mundësi kur vendosin se kur dhe si do të publikojnë raportet dhe gjetjet e tyre.

8. Kongresi shpreson gjithashtu se të dhënat e mbledhura nën Temën II do të jenë të dobishme për kolegët SAI-ve të BE-së gjatë shqyrtimit të auditimeve specifike për mekanizmat financiar të BE-së, përfshirë Mekanizmin e Stabilitetit European.